



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 653/4 prot.

Tiranë, më 05.12.2025

VENDIM
Nr. 69, datë 05.12.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 55, DATË 27.9.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 55, datë 27.9.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Rrogozhinë dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 49, datë 9.4.2024, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës, në Bashkinë Rrogozhinë”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Rrogozhinë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 55, datë 27.9.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Rrogozhinë dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë”*, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e këtij vendimi, në institucionin Bashkia Rrogozhinë, me urdhrin nr. 63, datë 2.7.2025, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim*

në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 55, datë 27.9.2024, të Komisionerit”, sipas objektit dhe drejtimeve që përmban programi i mbikëqyrjes, i cili është pjesë e këtij urdhri. Për nisjen e këtij procesi Bashkia Rrogzhinë është njoftuar me shkresën nr. 653/2 prot., datë 2.7.2025, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit paralajmërues nr. 55, datë 27.9.2024, të Komisionerit”. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes dhe në përfundim të procesit, mbajti një procesverbal, ku u evidentua situata në lidhje me ecurinë e masave të marra nga institucioni.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.55, datë 27.9.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, konstatohet se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në **pikën 2**, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, marrjen e masave si më poshtë:

Për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2023, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe pikës 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, si dhe duke u bazuar në orientimet e dhëna në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes, Njësia përgjegjëse e institucionit (Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore), duhet të veprojë si më poshtë:

- Të përcaktojë nëpunësin civil/grup pune, i cili është përgjegjës për mbledhjen e informacionit për pozicionet e punës në strukturën aktuale që janë pjesë e shërbimit civil dhe analizimin e këtij informacioni, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrave, përgjegjësi e kërkesave të veçanta të çdo pozicioni (përcaktimin e saktë të kërkesave lidhur me nivelin e arsimit, fushën kryesore të studimeve dhe përvojën në punë).

- Ky material t’u përcillet zyrtarisht nëpunësve përgjegjës për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës (epropori direkt i pozicionit respektiv të punës dhe Sekretari i Përgjithshëm), siç përcaktohet në kreun IV, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

- Pasi të përfundojë procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të përgatitë dokumentacionin e domosdoshëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës (Struktura dhe organika e hollësishme e institucionit që është në fuqi në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit dhe përshkrimet e punës për vendet e punës pjesë e shërbimit civil).

- Ky dokumentacion, nëpërmjet Zyrës së Arkiv Protokollit, t'i përcillet Komitetit të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil i cili duhet të konfirmojë me shkrim marrjen e tij. - Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, në zbatim të përcaktimeve të pikës 29/ç, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar, të krijojë Komitetin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, i cili do të përbëhet nga tre anëtarë: njëri nga anëtarët është i ngarkuari me detyrën e analistit të punës, ose ndonjë funksion tjetër të menaxhimit të burimeve njerëzore, kurse dy anëtarët e tjerë janë nëpunës civilë me përvojë në institucion.

- Komiteti i vlerësimit pas administrimit të dokumentacionit të domosdoshëm të identifikojë me saktësi vendet e punës që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit. Më tej, do të vijojë punën me vlerësimin e tyre duke u bazuar në përshkrimet e punës dhe në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në lidhjen nr. 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.

- Në përfundim të procesit të vlerësimit të hartohet një listë përmbledhëse ku të pasqyrohen pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, të klasifikuara në kategorinë dhe klasën përkatëse sipas klasave të zbatueshme për secilën kategori të përcaktuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe pikën 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.

- Lista përmbledhëse e klasifikimit racional në kategorinë dhe klasën përkatëse për gjithë pozicionet e shërbimit civil të strukturës që është në fuqi në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit t'i përcillet nëpërmjet Zyrës së Arkiv Protokollit, Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit dhe Njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.

- Për realizimin e kësaj detyre në përputhje me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, Komiteti i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, të bashkëpunojë dhe këshillohet me Departamentin e Administratës Publike, siç përcaktohet në pikën 37, kreu V, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.

Nga verifikimi i akteve të administruara konstatohet se, me urdhrin nr. 572, datë 25.11.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm, është ngritur Komiteti i Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve të punës të shërbimit civil, si strukturë përgjegjëse për administrimin e procesit të vlerësimit.

Njëkohësisht, me aktin nr. 933/1 prot., datë 28.2.2025, është hartuar dhe miratuar plani i rekrutimeve në shërbimin civil.

Në **pikën 3** të Vendimit Paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar rivendosjen e ligjshmërisë duke u marrë masat e mëposhtme:

Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të hartohet dhe miratohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil ku të shpallen për konkurrim të gjitha vendet vakante të shërbimit civil. Në këtë akt të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit, duke miratuar një planifikim të qartë të këtij procesi ku të përfshihet pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi. Pasi të përmbyllet ky proces, Kryetari i Bashkisë Rrogzhinë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit, për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë ligj, në pozicione pune të kategorisë ekzekutive, që aktualisht janë 44 raste, dhe të rregullojë pasojat, me qëllim që në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës pranë AKPA, për t'u plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimi të shërbimit civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit.

Nga analiza e akteve të administruara vërej se njësia përgjegjëse, me shkresën nr. 3033 prot., datë 23.7.2025, ka hartuar një plan veprimi për plotësimin e pozicioneve vakante të shërbimit civil.

Ndërkohë, konstatoj se Kryetari i Bashkisë Rrogzhinë ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me shërbimin civil për punonjësit si më poshtë:

1. Me urdhrin nr. 241, datë 17.5.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit me shërbimin civil për punonjësin Denis Kalaja;
2. Me urdhrin nr. 489, datë 7.10.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit me shërbimin civil për punonjësen Migena Qoshku;
3. Me urdhrin nr. 8, datë 10.1.2025, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit me shërbimin civil për punonjësin Klodian Allmeta;
4. Me urdhrin nr. 503, datë 10.10.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit me shërbimin civil për punonjësen Marjeta Kuqi;
5. Me urdhrin nr. 261, datë 31.5.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit me shërbimin civil për punonjësin Bashkim Çela;
6. Me urdhrin nr. 253, datë 23.5.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit me shërbimin civil për punonjësin Artor Gjoni;
7. Me urdhrin nr. 419, datë 2.9.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit me shërbimin civil për punonjësin Skender Dedej;

Në **pikën 4**, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit të nxjerra në kundërshtim me ligjin për 18 punonjësit e emëruar në pozicione pune të shërbimit civil.

Nga të dhënat e administruara vërej se se është bërë ndërpreja e marrëdhënies së punësimit për punonjësit më poshtë:

1. Me urdhrin nr. 599, datë 24.12.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit me shërbimin civil për punonjësin Olsi Dranga;
2. Me urdhrin nr. 430, datë 13.9.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punësimit me shërbimin civil për punonjësen Anita Hakani;

Në **pikën 5** të vendimit paralajmërues Komisioneri ka kërkuar që dosjet e personelit të plotësohen dhe sistemohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i kryer nga grupi i punës, i cili shqyrtoi disa dosje të përzgjedhura rastësisht, rezultoi se kjo kërkesë është përmbushur.

Në **pikën 6** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Njësia përgjegjëse të hartojnë dhe miratojnë një plan veprimi për zbatimin e vendimit paralajmërues, i cili të përmbajë: veprimet administrative që do të ndërmerren, personat përgjegjës për realizimin e tyre dhe afatet konkrete për përfundimin e secilit veprim.

Nga aktet e administruara konstatoj se është hartuar dhe miratuar plani i veprimit me aktin nr. 3033 prot., datë 23.7.2025, “Plan veprimi i burimeve njerëzore për plotësimin e vendeve vakante sipas ligjit për nëpunësin civil” të Sekretarit të Përgjithshëm, përsa i përket vendeve vakante të shërbimit civil.

Në përfundim, në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, rezulton se Bashkia Rrogozhinë ka filluar zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 55, datë 27.9.2024, të Komisionerit, nëpërmjet veprimeve konkrete administrative, për të gjitha detyrat e lëna, por ende nuk e ka përfunduar atë. Problematika në këtë rast, qëndron kryesisht në drejtim të dy aspekteve të administrimit të shërbimit civil, që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil dhe rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, edhe pse, nga institucioni janë marrë masa për t’i nisur dhe zhvilluar këto procese, por ende ato nuk janë finalizuar me akte përfundimtare.

Në kushtet kur këto procese kanë një nivel kompleks vështirësie që kërkon njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore si edhe kapacitete të mjaftueshme në përbërje dhe mbështetje të njësisë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore të institucionit, të cilat janë të kufizuara në njësitë e administratës vendore, e sidomos në këto bashki me një numër relativisht të ulët banorësh, e po kështu, duke njohur faktin se

këto procese kërkojnë një periudhë kohore relativisht të gjatë për t'u implementuar, si për shkak të afateve procedurale, ashtu edhe për arsye të ndryshme objektive, që kryesisht qëndrojnë në mungesën e kandidatëve të interesuar për të marrë pjesë në procesin e rekrutimit, vlerësojmë se për realizimin e detyrave, institucionit duhet t'i mundësohet një afat kohor që shkon përtej atij të vendosur nga Komisioneri në vendimin e paralajmërimit.

Në këto kushte, vlerësoj se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 55, datë 27.09.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Rrogozhinë dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë”*.
2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Rrogozhinë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha